



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 janar 2015
Nr. ref.: RK757/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI51/14

Parashtrues

Radomir Radosavljević

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 301/2013, të 17 dhjetorit 2013

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Radomir Radosavljević. Ai përfaqësohet nga z. Agim Lushta, avokat, banor i Mitrovicës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 301/2013, të 17 dhjetorit 2013. Ky aktgjykim i ishte dorëzuar parashtruesit më 8 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 prill 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 21 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës.
8. Më 6 qershor 2014, Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës (MPB-PK), përmes përfaqësuesit të saj ligjor, Departamenti për Përfaqësim Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, dorëzoi sqarime shtesë.
9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës rrjedh se parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Policinë e Kosovës, në stacionin e policisë në Zveçan, në Drejtorinë Rajonale të Mitrovicës, në pozitën e Togerit të Policisë. Në kohën e ngjarjeve të përshkruara më poshtë ai ishte Udhëheqës i Njësisë së Sigurisë në Gjykatën e Mitrovicës-Veri.

11. Më 13 maj 2011, parashtruesi i kërkesës ishte emëruar komandant i stacionit të policisë në Zveçan. Ky vendim do të hynte në fuqi më 16 maj 2011, në të cilën ditë pritej që parashtruesi të paraqitej në detyrë në këtë funksion të ri. Nga shkresat shihet që parashtruesi i kërkesës në këtë kohë ka qenë në pushim vjetor.
12. Më 24 maj 2011, pasi që parashtruesi ende nuk ishte paraqitur në detyrë si Komandant i Stacionit Policor në Zveçan, kishte filluar një hetim i brendshëm disiplinor kundër tij, dhe parashtruesi ishte suspenduar nga detyra për 48 orë, efektshëm nga 25 maji 2011. Me sa duket, në këtë kohë parashtruesi ishte paraqitur në detyrë përsëri në vendin e tij të mëparshëm si Udhëheqës i Njësisë së Sigurisë në Gjykatën e Mitrovicës-Veri.
13. Më 4 korrik 2011, marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës me Policinë e Kosovës ishte ndërprerë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës në bazë të "mosbindjes së rëndë nga neni 46 (b) të Ligjit, Nr. 03/L-035 (Ligji për Policinë) të 20 shkurtit 2008, dhe siç përcaktohet më tej në udhëzimet përkatëse administrative. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi te Ministri i Punëve të Brendshme.
14. Më 19 gusht 2011, Ministri i Punëve të Brendshme refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi paraqiti padi kundër këtij vendimi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë.
15. Më 24 dhjetor 2012, me Aktgjykimin C. nr. 188/2011, Gjykata Komunale në Mitrovicë anuloi Vendimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme, të 19 gushtit 2011 dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, të 4 korrikut 2011, me të cilin i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës parashtruesit të kërkesës. Gjykata Komunale në Mitrovicë urdhëroi Ministrinë e Punëve të Brendshme ta kthejë parashtruesin e kërkesës në pozitën e tij të mëparshme në Polici të Kosovës dhe t'ia kompensojë atij shpenzimet e procedurës gjyqësore.
16. Gjykata Komunale në Mitrovicë bazoi vendimin e saj, *inter alia*, në arsyet e mëposhtme:

“Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë sa më të drejtë dhe të plotë u lëshua në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të emërimit gjë që e kërkonte edhe pala paditëse ndërsa në këtë rast kjo çështje konsiston si çështje paraprake, sepse kjo është e lidhur ngushtë me vendimin mbi ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe se vetëm në këtë mënyrë mund të vërtetohet gjendja në faktike në tërësi.

Sipas Ligjit për Policinë [Ligji Nr. 03/L-035 i 20 shkurti 2008], neni 40 dhe neni 41 e kërkojnë si kusht që përzgjedhja apo emërimi i komandantëve në stacionet policore bëhet në bashkëpunim me autoritetet lokale (bashkësitë lokale), e sidomos në vendet apo lokalitetet ku shumicë përbënë komuniteti serb. Sipas po të njëjtit ligj, udhëheqja lokale i jep 3 propozime për komandantë pas kërkesës së drejtorit të përgjithshëm të policisë së Kosovës të bërë në drejtim të tyre. Në rastin konkret në shkresat e lëndës nuk ka asnjë shkresë me të cilën do të vërtetohet se drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës i ka bërë kërkesë autoriteteve lokale për emërimin e

komandantëve të stacioneve përkatëse, ndërsa një gjë të tillë nuk arriti ta provoj e paditura [gjegj. Ministria e Punëve të Brendshme] as në seanca gjyqësore

[...]

[Parashtruesi i kërkesës] akuzohet për mosbindje të rëndë (moszbatim të urdhërit dhe mungesës pa arsye për më shumë se tri ditë në punë) që sanksionohet si shkelje e rëndë sipas ligjit për policinë dhe udhëzimeve administrative.

[...]

Më lart u potencua fakti se vendimi mbi emërimin është jo i ligjshëm, pikërisht sepse është bërë pa u konsultuar fare me autoritet lokale në atë komunë, kjo pastaj ka pasuar me pamundësinë e [parashtruesit e kërkesës] për të zbatuar vendimin, jo me refuzimin për një gjë të tillë. Pamundësia dhe refuzimi janë terme diametralisht të kundërta, përderisa pamundësia ka të bëjë me mungesën e kushteve apo rrezikun në rast zbatimi të vendimit përkundër vullnetit dhe dëshirës së paditësit, ndërsa te refuzimi kemi të bëjmë me një refuzim apo jo gatishmëri për zbatim.

[...]

Nga shkresat tjera të lëndës vërtetohet fare qartë se [parashtruesi i kërkesës] nuk ka mundur ta ushtroi pozitën e re, ndërsa është kthyer dhe ka punuar në pozitën e mëhershme si shef i njësisë së sigurimit të gjykatës në veri, do të thotë nuk kemi as mungesë pa arsye [...].

Ndërsa krejt në fund gjykata konsideron se paditësi edhe ashtu nuk ka qenë i obliguar ta zbatoj vendimin e tillë mbi emërimin pasi që ky vendim ka qenë i paligjshëm, ku në nenin 13 paragrafi 2 thuhet se: "Zyrtari policor ka për detyrë t' i refuzojë urdhrat të cilët janë qartësisht të paligjshëm dhe të raportojë për ta, pa u frikësuar nga ndëshkimi."

[...]"

17. Më 5 korrik 2013, me Aktgjykimin AC. nr. 419/2013, Gjykata e Apelit refuzoi si të pabazuar ankesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Mitrovicës. Ministria e Punëve të Brendshme paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.
18. Më 17 dhjetor 2013, me Aktgjykimin Rev. nr. 301/2013, Gjykata Supreme aprovoi revizionin si të bazuar. Gjykata Supreme konsideroi se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar drejtë faktet e rastit, por kanë zbatuar gabimisht ligjin. Në veçanti, Gjykata Supreme hodhi poshtë pretendimin se vendimi për të caktuar parashtruesin e kërkesës në pozitën e Komandantit të Stacionit të Policisë së Zveçanit ishte i paligjshëm, dhe se, për këtë arsye, vendimi për ndërprerjen e punësimit të tij ishte i paligjshëm. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme konsideron se:

"Një pikëpamje e tillë juridike për këtë Gjykatë është e papranueshme, sepse objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike nuk është vlerësimi i ligjshmërisë së emërimit [të parashtruesit të kërkesës] në vendin e komandantit të Stacionit Policor të Zveçanit, por vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës".

19. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konkludoi se:

“Për këto arsye, janë të bazuara pretendimet e ngritura në revizion se të dy aktgjykimet e goditura janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, prandaj ato u ndryshuan dhe kërkesëpapia [e parashtruesit të kërkesës] u refuzua si e pabazuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme i ka mohuar atij të drejtën për një gjykim të drejtë, sepse nuk arriti të adresojë objektin e çështjes.
22. Parashtruesi i kërkesës theksoi se:

“Objekti i kontestit i pretenduar nga paditësi ka qenë ligjshmëria e vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011 me të cilën pala – [parashtruesi i kërkesës] emërohet Komandant i stacionit policor në Zveçan [...] Gjykata Supreme e Kosovës nuk është shprehur ne se vendimi Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011 është i ligjshëm apo jo.

[...]

Gjykata Supreme [...] e kishte për detyrë të kryente një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm e në përputhje me ligjin (neni 7 dhe 8 K. Pr. kontestimore) për të sqaruar nëse vendimi Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011 është në pajtim apo në kundërshtim me ligjin. Duke mos u shprehur për ligjshmërinë e vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011, gjykata Supreme ka lënë pa zgjidhur mosmarrëveshjen objekt i gjyqimit”.

23. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës konsideron se:

“Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me zbatimin e vendimit për emërimin e komandantëve në pozitat e reja komanduese në pjesën veriore të Kosovës, duhet të kishte parasysh se edhe vetë policia e Kosovës e cila në radhët e veta ka afër 10.000 pjesëtarë, nuk ka mundur që të depërtojë në këto lokalitete përkundër forcës së saj. Gjatë tentimit për të marrë pjesët e këtyre lokaliteteve ka ra si dëshmor i ndjeri polici Enver Zymeri dhe shumë të tjerë janë plagosur. Kjo tregon se vullneti i [parashtruesit të kërkesës] dhe mundësia e zbatimit të vendimit të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës për tu bërë komandant i stacionit policor në Zveçan ishte e barabartë me zero, pasi që këtu kemi pas të bëjmë me një person të vetëm të lënë në mëshirë dhe të pa ndihmuar nga institucionet relevante për zbatim të vendimit të drejtorit të Përgjithshëm”.

24. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ishte trajtuar në mënyrë të barabartë, në shkelje të nenin 24 të Kushtetutës, sepse, “[...] ndërimi

i komandantëve është bërë në mënyrë selektive përkatësisht vetëm në rajonet ku banojnë komuniteti serb në shumicë të banorëve e jo edhe në rajonet tjera, gjë që tregon qartë qëllimet politike të vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të policisë së Kosovës me çka shkaktohet diskriminimin nacional dhe shkelje të nenit 2 dhe 3 të ligjit kundër diskriminimit”.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjkata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Gjkata duhet gjithashtu të vërtetojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe të nenit 47.2 të Ligjit. Neni 113, paragrafi 7 parasheh se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
27. Vendimi i fundit për rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 301/2013, i 17 dhjetorit 2013. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit.
28. Parashtruesi i kërkesës duhet gjithashtu të dëshmojë se i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës mund të shihet se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 301/2013, i 17 dhjetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më ose rreth 8 shkurtit 2014, ndërsa parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatë më 19 mars 2014, që do të thotë se kërkesa është paraqitur brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të parashikuar me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Gjkata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohen të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë). Prandaj, në këtë rast, Gjkata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-l).
30. Gjkata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa Nr. 13071/87, e 10 korrikut 1991).

31. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit të aplikueshëm në Gjykatën Supreme. Interpretimi i objektit të çështjes së rastit është në kuadër të fushëveprimit të Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thirret në nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës Supreme, i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e pengon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Me vendimin e saj, Rev. nr. 301/2013, Gjykata Supreme thjesht vërtetoi se punësimi konkret i parashtruesit të kërkesës me Policinë e Kosovës ishte ndërprerë në mënyrë të ligjshme. Kjo në asnjë mënyrë nuk e pengon ose ndalon parashtruesin e kërkesës që të fillojë ndonjë punë tjetër që ai mund të zgjedhë. Si të tillë, nuk ka asgjë në pretendimet e parashtruesit që arsyeton përfundimin se atij i është cenuar e drejta kushtetuese e punës.
33. Përveç kësaj, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me diskriminimin në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës është i bazuar në pretendimin e tij se në kohën e shkarkimit të tij nga puna, komandantët e rinj të stacioneve ishin emëruar vetëm në zonat e populluara me shumicë nga pjesëtarët e komunitetit serb. Parashtruesi nuk ka treguar se si kjo ka të bëjë me emërimin e komandantëve të stacioneve në zonat tjera të Kosovës, dhe në çfarë mënyre emërimi i tij ishte ndryshe nga ai i komandantëve të stacioneve të tjera.
34. Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar se, si emërimi dhe shkarkimi pasues i tij paraqet trajtim jo të barabartë në lidhje me të tjerët në situata të ngjashme.
35. Në përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.
36. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores së punës parasheh se “Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (2) (d) e 56 (2) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani